



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 253/6 prot.

Datë 10.02.2026

V E N D I M

Nr. 232/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.02.2026 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ergi” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-70501-11-27-2025, me objekt: “Rikonstruksion, i disa rrugeve te brendshme te Bashkise Belsh, Faza III”, me fond limit 113,802,153.88 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Belsh
Adresa: Rruga “Haziz Dervishi”, Belsh

Ankimues:

Operatori ekonomik “Ergi” SHPK, me NIPT K02727229P, dhe adresë Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, Lagjja 28 Nentori.

Operatori ekonomik “Salillari” SHPK, me NIPT J62903125G, dhe adresë Lagjia 4 Shtatori , Ura Vajgurore, Dimal..

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat janë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj ato duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.5. Operatori ekonomik “Ergi” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Operatori ekonomik “Salillari” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.12.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-70501-11-27-2025, me objekt: “Rikonstruksion, i disa rrugeve te brendshme te Bashkise Belsh, Faza III”, me fond limit 113,802,153.88 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

II.2. Në datën 05.01.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 22.01.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

METEO	79,898,677.96 lekë	Skualifikuar
SHKELQIMI 07	70,700,741.17 lekë	Skualifikuar
2 N	65,692,648 lekë	Skualifikuar
A.N.K	96 722 276.69 lekë	Kualifikuar
AGI KONS	95 993 686.80 lekë	Skualifikuar
BAJRAMI N	82,974,210.58 lekë	Skualifikuar
BAMI HOLDING	80 286 795.12 lekë	Kualifikuar
BESTA	74 311 367 lekë	Skualifikuar
BIBA-X	73,779,113.75 lekë	Kualifikuar
BONUS	85 060 449.50 lekë	Kualifikuar
COMPANY RIVIERA2008	89,902,581 lekë	Skualifikuar
DEHA 2010	85,362,569.62 lekë	Skualifikuar
BOE EN-SAL Alko Impex Construction	80 993 033.12 lekë	Skualifikuar
ERGI	67,889,602.05 lekë	Skualifikuar
EUROTEOREMA PEQIN	73 365 325.67 lekë	Kualifikuar
BOE FLED & S.M.O Union	69 796 924.53 lekë	Skualifikuar
K A C D E D J A	81 889 778 .38 lekë	Skualifikuar
HASTOCI	98 389 738.02 lekë	Skualifikuar
BOE K.M.K & Caushi M	79,432,774 lekë	Skualifikuar
BOE K.TURJA & KEGLI- DURI	84,165,813 lekë	Skualifikuar
L.T.E CONSTRUCTION	65,982,791.22 lekë	Skualifikuar
LIQENI VII	81 794 024.92 lekë	Skualifikuar
NDREGJONI	87,072,254.52 lekë	Kualifikuar
RSM COMPANY	76,430,995 lekë	Skualifikuar
SALILLARI	70 500 000 lekë	Skualifikuar
Shendelli	60,440,307 lekë	Skualifikuar
VELLEZERIT HYSA	73,559,520.03 lekë	Skualifikuar

II.4 Në datën 27.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 27.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. nr. A/2026/6283 dhe nr.253/2026 prot, datë 27.01.2026 i operatorit ekonomik “Ergi” SHPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ergi” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.253/1 prot, datë 28.01.2026.

II.5.2. Autoriteti kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, më datë 02.02.2026 ka dërguar vendimin e KSHA nr.317 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr.253/2 prot., datë 02.02.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Ergi” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.5.3. Autoriteti kontraktor, vendimin e KSHA nr.317 prot., datë 02.02.2026, së bashku me informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.320 prot., datë 02.02.2026 protokolluar me tonën me nr.253/3 prot., datë 05.02.2026.

II.6. Në datën 30.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. nr. A/2026/6294 dhe nr.300/2026 prot, datë 30.01.2026 i operatorit ekonomik “Salillari” SHPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.300/1 prot, datë 02.02.2026.

II.6.2. Autoriteti kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, më datë 02.02.2026 ka dërguar vendimin e KSHA nr.322 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr.300/2 prot., datë 02.02.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Salillari" SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranimin e saj, duke argumentuar:[...] *Nga shqyrtimi i plotë i këtyre dokumentave konstatohet se operatori ekonomik "Salillari" shpk. ka përmbushur kriterin e përcaktuar në piken 2.3.3 të Dokumentave Standarte të Tenderit, duke paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar.*

Në këto kushte AK, Bashkia Belsh dhe KSHA vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik është i bazuar, pasi nga verifikimet në SPE rezulton se dokumentacioni për Drejtuesin Teknik është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e DST-ve dhe Ligjit Nr:162: datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, të dispozitave të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Në përfundim, Autoriteti Kontraktor i qëndron mendimit se operatori ekonomik "Salillari" shpk plotëson kriterin e mësipërm dhe i lë në vlerësim Komisionit të Prokurimit Publik marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me ankesën.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Salillari" sh.p.k. qëndron dhe në mbështetje të nenin 109 e vijues të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", " i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, neni 94 e vijues i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", komisioni i shqyrtimit të ankesës,

VENDOS

Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik " SALILLARI" shpk me nr Nipti J62903125G, me adrese Rruga Bilal Sina, pallati Salillari shk.3, Kati 1 Tirane, me administrator Z. Bledar Strarova.

II.6.3. Autoriteti kontraktor, vendimin e KSHA nr.322 prot., datë 02.02.2026, së bashku me informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.341 prot., datë 04.02.2026 protokolluar me tonën me nr.300/3 prot., datë 06.02.2026

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton se, nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të intersuar në kuptim të nenit 113 të LPP i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Ergi” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 02.12.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-70501-11-27-2025, me objekt: “Rikonstruksion, i disa rrugeve te brendshme te Bashkise Belsh, Faza III”, me fond limit 113,802,153.88 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

III.1.2. Në datën 05.01.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton se më datë 27.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.4 Në datën 27.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. nr. A/2026/6283 dhe nr.253/2026 prot, datë 27.01.2026 i operatorit ekonomik “Ergi” SHPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ergi” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.253/1 prot, datë 28.01.2026.

III.1.6 Autoriteti kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, më datë 02.02.2026 ka dërguar vendimin e KSHA nr.317 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr.253/2 prot., datë 02.02.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Ergi” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

III.1.7. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.*”

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.8. Ne nenin 97 pika 1 dhe 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1.Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.”

III.1.9. Në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit,, **Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31.** Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....; “... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: “... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. **Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**”, si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e ulët monetar siç është procedura e prokurimit objekt

ankimi, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit ose njoftimit të anulimit dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

III.1.10. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt ankimi është publikuar me datë 27.01.2026. KPP vëren, se me datë 27.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi nr. A/2026/6283 dhe nr.253/2026 prot, datë 27.01.2026 e operatorit ekonomik “ERGI” SHPK. Ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se në këtë datë (27.01.2026) kur është paraqitur ankesa nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pavarësisht se ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak, afati i ankimit nuk kishte filluar të ecte për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të nenit 97 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse. Gjithashtu edhe në vlerësim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Apelit **afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**”,

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike përpara afatit të parashikuar nga neni 97 pika 5 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar në të cilin parashikohet se: “*5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.*” por edhe nga vlerësimi që Gjykata Administrative e Apelit përmes vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 i ka bërë nisjes së llogaritjes së afatit të ankimit administrativ. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar ende, për sa kohë sipas parashikimeve më sipër dita e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak (data 27.01.2026 kur edhe është paraqitur në sistem ankesa) nuk përfshihet në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar me datë 27.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të

ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Salillari ” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Autoriteti kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, më datë 02.02.2026 ka përcjellë vendimin e KSHA nr.322 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr.300/2 prot., datë 02.02.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Salillari” SHPK.

III.2.2. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, duke argumentuar:

[...] Nga shqyrtimi i plotë i këtyre dokumentave konstatohet se operatori ekonomik "Salillari" shpk. ka përmbushur kriterin e përcaktuar në piken 2.3.3 të Dokumentave Standarte të Tenderit, duke paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Në këto kushte AK, Bashkia Belsh dhe KSHA vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik është i bazuar, pasi nga verifikimet në SPE rezulton se dokumentacioni për Drejtuesin Teknik është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e DST-ve dhe Ligjit Nr.162: datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, të dispozitave të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Në përfundim, Autoriteti Kontraktor i qëndron mendimit se operatori ekonomik "Salillari" shpk plotëson kriterin e mësipërm dhe i lë në vlerësim Komisionit të Prokurimit Publik marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me ankesën.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Salillari”sh.p.k. qëndron dhe në mbështetje të nenin 109 e vijues të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", " i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, neni 94 e vijues i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", komisioni i shqyrtimit të ankesës,

VENDOS

Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik " SALILLARI" shpk me nr Nipti J62903125G, me adrese Rruga Bilal Sina, pallati Salillari shk.3, Kati 1 Tirane, me administrator Z. Bledar Strarova.

III.2.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3

nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.2.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.5. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Salillari” SHPK, për sa kohë nuk ka ankesë nga operatorë ekonomikë të interesuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ergi” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-70501-11-27-2025, me objekt: “Rikonstruktion, idisarrugeve te brendshme te Bashkise Belsh, Faza III”, me fond limit 113,802,153.88 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
2. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK, në zbatim të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr.322 prot., datë 02.02.2026, duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA -së, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ergi” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

